

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5863  
E mërkurë, 28 gusht 2019  
çmimi 0.40 €

## Djali i Adem Demaçit i bashkohet PDK-së

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA FILLUAR PËRGATITJET PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE

FAQE 3

# Fushata zgjedhore nis më 25 shtator, përfundon më 4 tetor



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që fushata zgjedhore e partive politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të jetë dhjetë ditë, e cila do të fillojë më 25 shtator dhe do të përfundojë më 4 tetor. Po ashtu, KQZ-ja ka bërë me dije se deklarimi për koalicion

parazgjedhore nga ana e subjekteve politike fillon më 27 gusht dhe përfundon më 30 gusht. Afati për regjistrimin e votuesve jashtë vendit do të jetë i hapur nga data 30 gusht deri më 10 shtator. Për organizimin e këtyre zgjedhjeve, KQZ-së i duhen rreth 6 milionë euro

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUZAFER SHALA

FAQE 4-5

## Qendrat inovative do të kenë shtrirje në tërë Kosovën

Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka thënë se me platformën e kësaj ministrie brenda një periudhe dhjetëvjeçare do të krijohen 50 mijë vende punë në IT. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qendrat inovative do të kenë shtrirje në tërë Kosovën. "Kemi paraparë që t'i kemi 15 qendra të inovacionit brenda katër vjetësh, po ashtu kemi paraparë t'i kemi 5 000 start up biznese inovative për një periudhë dhjetëvjeçare, kurse 1 800 sosh vetëm për katër vjetët e ardhshëm", ka thënë Shala. Në këtë intervistë Shala ka folur edhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, duke theksuar se PDK-ja në këto zgjedhje do të dalë partia e parë



## Zvogëlohen gjasat për arritjen e koalicionit LDK - LV

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### AKTUALE

LABINOT TAHIRI ADERON  
NË AAK F. 7

HAPJA E AMBASADËS  
JAPONEZE DO TË THELLOJË  
MARRËDHËNIET BILATERALE  
KOSOVË-JAPONI F. 5



PROMOVHET PROJEKTI  
I BASHKËPUNIMIT  
NDËRKUFITAR  
GJILAN - KUMANOVË F. 10

### EKONOMI



BORXHI I PËRGJITHSHËM  
I KOSOVËS TEJKALON  
1.1 MILIARD EURO F. 9

FIRMA GJERMANE, E GATSHME  
PËR INVESTIME NË MALISHEVË

F. 8

### SPORT

FAZLIU: NA PREKU HUMBJA,  
RIKTHEHEMI NDAJ PRISHTINËS

F. 13

KRASNIQI DHE HARTELI  
LUFTOJNË PËR FITORE F. 13



## Ursula Von Der Leyen përzgjedh komisionarët e BE-së

**BRUKSEL, 27 GUSHT** - Presidentja e ardhshme e Komisionit Evropian, Ursula Von Der Leyen, ka filluar të martën zyrtarisht bisedimet për përzgjedhjen e kandidatëve që duan të marrin postet e komisionarëve të BE. Britania e Madhe ka hequr dorë nga dërgimi i kandidatëve, pasi më 31 tetor dëshiron të dalë nga BE-ja. Von Der Leyen dëshiron të verifikojë më parë, nëse janë të përshtatshëm emrat e dërguar nga shtetet anëtare për poste dhe të bisedojë për detyrat e mundshme. Komisionarët qëndrojnë për 5 vjet

në post, deri në zgjedhjet e reja evropiane. Komisioni Evropian i ngjason një qeverie me disa fusha të ndryshme, i cili propozon ligje të BE-së dhe vëzhgon respektimin e tyre. Von der Leyen parashikon të zë të paktën 50 për qind të posteve të komisionarëve me kandidatë femra, por deri tani ka 13 emra burrash të propozuar dhe 10 femra. Nga shtatori personat e emëruar do duhet të paraqiten para Parlamentit Evropian, që në fund duhet ta miratojë Komisionin e ri Evropian.

Emrat e dërguar nga qeveritë e vendeve anëtare normalisht mbahen të fshehtë deri në emërimin e tyre përfundimtar. Në media janë përmendur megjithatë, emra si Frans Timmermans, ish-zëvendës-president i Komisionit Evropian, që përflitet se do të drejtojë sektorin e klimës, një fushë e rëndësishme për von der Leyen, apo emri i ministrit të Jashtëm belg, Didier Reynders, që është propozuar nga Qeveria belge. Edhe kandidatja liberale, Margaret Vestager përflitet për poste të larta në Komisionin e ri Evropian.



## Cakaj: Shqipëria do të promovojë luftën kundër radikalizmit dhe terrorizmit

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Gent Cakaj në takim me ministrin e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Jordanisë, Ayman Al Safadi tha se Shqipëria do të promovojë luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit, fuqizimin e rolit të gruas dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar



**TIRANË, 27 GUSHT** - Ministri në Detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj zhvilloi një vizitë pune në Jordani, ku u prit në një takim nga ministri i Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Jordanisë, Ayman Al Safadi. Fokus i takimit ishin marrëdhëniet dypalëshe, kryesimi nga Shqipëria i Grupit të Kontaktit të Mesdheut të OSBE-së si dhe prioritetet e Kryesisë shqiptare të OSBE-së 2020. Gjatë takimit, ministri Cakaj u ndal te kryesimi i Grupit të Kontaktit të Mesdheut të OSBE-së, duke shprehur angazhimin e plotë të Shqipërisë në marrjen e kësaj iniciative. Në këtë kuadër, ministri në Detyrë, Cakaj, u fokusua tek avancimi i dialogut me vendet

partnere në fushat me interes të përbashkët, ku OSBE-ja sjell një vlerë të shtuar në çështje si: sfidat e sigurisë, forcimin e rolit të rinisë në shoqëri dhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik, ka njoftuar ATSH. Ministri në Detyrë, Cakaj, informoi ministrin Al Safadi mbi zhvillimin e Konferencës së Mesdheut, që do të organizohet në Tiranë më 24-25 tetor 2019 dhe rëndësinë e tematikave që ajo do t'i trajtojë. Më tej, dy bashkëbiseduesit u ndalën te kryesimi shqiptar i OSBE-së, si një ndër prioritetet kyçe të Shqipërisë përgjatë vitit 2020. Ministri Cakaj garantoj homologun Al Safadi se Shqipëria do të inkurajojë frymën e bashkëpunimit dhe konsensusit

në vendimmarrje si dhe siguroi se përpjekjet për zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e tyre do të jenë në krye të agjendës shqiptare. Gjithashtu, ministri në Detyrë, Cakaj, theksoi se Shqipëria do të promovojë luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit, fuqizimin e rolit të gruas dhe

luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Nga ana e tij ministri i Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Jordanisë, Ayman Al Safadi nënvizoi se Jordania kërkon vijimin e bashkëpunimit dhe angazhimit me OSBE-në përmes aktiviteteve në kuadër të Partneritetit për Mesdheun, shkëmbimit të ndërsjellë, praktikave të mira dhe

ndërtimit të kapaciteteve për sfidat aktuale. Në këtë kuadër u vlerësua Konferenca e Mesdheut, e cila do të organizohet në Tiranë më 24-25 tetor 2019.

Nën kryesinë shqiptare për vitin 2019 të Grupit të Kontaktit me Partnerët Mesdhetarë të OSBE-së, Jordania vijon të ketë një rol tepër aktiv, me kontribut konkret, për çështje si kthimi i luftëtarëve të huaj (FTF), dialogu ndërfaqësor etj. Gjithashtu, Al Safadi tha se Jordania vlerësoi me nota pozitive rolin dhe përpjekjet e kryesisë shqiptare të GKM-së për të konsoliduar më tej dialogun dhe bashkëpunimin mes vendeve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe atyre partnere të Mesdheut. Ministri Al Safadi garantoj angazhimin e tij për përfaqësimin e Jordanisë në këtë konferencë. Në këtë kuadër, ministrat shprehën angazhimin e tyre të plotë për nxitjen e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, në mënyrë që të përfitohet sa më shumë nga potenciali real që ekziston për rritjen e shkëmbimeve tregtare, nxitjen e investimeve, apo fuqizimin e bashkëpunimit ekonomik.

## Zaevi: Mundësitë për fillimin e negociatave me BE-në janë reale

**SHKUP, 27 GUSHT** - Kryeministri i Maqedonisë Veriore, Zoran Zaev, bashkë me zëvendëskryeministrin për Çështje Evropiane, Bujar Osmani dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, iu drejtuan mbledhjes së Këshillit të Ambasadorëve, që në organizim me MPJ është mbajtur në Klubin e Deputetëve në Shkup. Në takimin në temë "Perspektiva evropiane e Republikës së Maqedonisë së Veriut", në prag të Këshillit të BE-së në tetor, kryemi-

nistri Zaev para të pranishmëve dhe ushtrues të detyrave nga përfaqësitë konsullorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shprehu optimizëm se BE-ja do t'i vlersojë rezultatet e arritura të vendit, në plan të brendshëm e të jashtëm dhe sipas sistemit të meritave do të sjellë vendim pozitiv për fillimin e negociatave të vendit tonë me Unionin. Zaev i porositi të pranishmit që "të vazhdojmë të ndërtojmë miqësi", dhe secili të bëjë përpjekje maksi-

male në ndryshimet pozitive historike që po bëhen për vendin. "Mundësitë që ta fitojmë vendimin për fillimin e negociatave me BE-në janë reale, dhe kjo do të jetë një motivim i fortë për qytetarët, institucionet dhe për shtetin që të vazhdojnë të hapërojnë përpara drejt botës bashkëkohore. Beneficionet e qytetarëve nga procesi integruar me NATO-në tanimë po ndjehen, kemi rezultate të mira ekonomike dhe ata vetëm do të rriten", tha Zaevi.





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

# Fushata zgjedhore nis më 25 shtator, përfundon më 4 tetor

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që fushata zgjedhore e partive politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të jetë dhjetë ditë, e cila do të fillojë më 25 shtator dhe do të përfundojë më 4 tetor. Po ashtu, KQZ-ja ka bërë me dije se deklarimi për koalicione parazgjedhore nga ana e subjekteve politike fillon më 27 gusht dhe përfundon më 30 gusht. Afati për regjistrimin e votuesve jashtë vendit do të jetë i hapur nga data 30 gusht deri më 10 shtator. Për organizimin e këtyre zgjedhjeve, KQZ-së i duhen rreth 6 milionë euro

në KQZ kanë thënë se buxheti për zgjedhje duhet të ndahet sa më shpejt. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i SKQZ-së, Enis Halimi, ka kërkuar që alokimi i mjeteve të bëhet sa më shpejt që është e mundur për të filluar procedurat. Sipas tij, në të kundërtën nuk mund të nisë asnjë procedurë që ka të bëjë me procesin zgjedhor.

Ministri në detyrë i Financave, Bedri Hamza, ka bërë me dije se kanë pranuar një draft-kërkesë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për ndarjen e buxhetit për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Hamza ka thënë për "Epokën e re" se, pas qartësimit të situatës nga Gjykata Kushtetuese lidhur me kompetencat e qeverisë pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga posti i kryeministrit, do t'i kryejnë të gjitha obligimet në raport me këto dy institucione. Më tutje, ai ka thënë se shuma e kërkuar për organizimin e zgjedhjeve është e përbalueshme por, sipas tij, fillimisht duhet ta thotë fjalën Gjykata Kushtetuese. "Ndonëse ky vit nuk ka qenë vit zgjedhor, duke u bazuar në përvojën e punës sonë në institucione, kemi ndarë një fond në kuadër të Ministrisë së Financave i cili mund të përdoret në rast nevoje. Pra, në këtë fond janë rreth 20 milionë euro, i cili nuk është vetëm për një qëllim, por edhe

për qëllime të tjera. Mirëpo në rast nevoje, mbi bazën e nenit 15, paragrafit 2 dhe 7 të ligjit, ministri i Financave ka të drejtë ta bëjë transferimin e këtyre mjeteve në cilëndo kategori ekonomike dhe në cilëndo organizatë buxhetore. Pasi kryeministri i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ne jemi në përgjigje të kësaj gjykate dhe mbi bazën e përgjigjes së Gjykatës Kushtetuese do t'i kryejmë të gjitha veprimet e nevojshme. Kemi marrë një draft-kërkesë nga KQZ-ja dhe PZAP-ja për buxhetin që u nevojitet për këto zgjedhje. Nuk është shumë e cila nuk mund të mbulohej, mirëpo vetëm po presim qartësim të situatës juridike", ka thënë Hamza.

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës do të mbahen më 6 tetor. Të hënën presidenti Thaçi ka dekretuar shpërndarjen e legjislaturës së VI të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Javën e kaluar, me 89 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për shpërndarjen e legjislaturës së gjashtë, duke e çuar vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Propozimi i deputetëve për shpërndarjen e Kuvendit pason pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës më 19 korrik, pasi të njëjtën ditë kishte marrë ftesë nga Gjykata Speciale e Kosovës me seli në Hagë, për t'u

intervistuar në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte. Që nga dorëheqja e Haradinajt, partitë politike kanë nisur një lloj fushate ende të pashpallur zgjedhore. Ndërkohë që janë arritur edhe koalicionet e para parazgjedhore si dhe kanë nisur bisedimet ndërmjet partive politike për koalicione eventuale para apo pas zgjedhjeve.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka lidhur koalicion parazgjedhor me Partinë Socialdemokrate (PSD), kurse Nisma Socialdemokrate ka lidhur koalicion me Aleancën Kosova e Re (AKR).

Zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë u mbajtën më 11 qershor 2017. Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, numri i votuesve të regjistruar atë kohë ishte 1.888.059, kurse pjesëmarrja në zgjedhje ishte 43 për qind, apo 779,729 votues. Pas zgjedhjeve të vitit 2017, ishte konstituuar Kuvendi dhe më pas, më 9 shtator, ishte formuar edhe Qeveria e Kosovës, me Ramush Haradinajn kryeministër.

Përfundimi i mandatit të qeverive dhe legjislativave të Kosovës para skadimit të mandatit kushtetues, katërvjeçar, tashmë është bërë "praktikë", ngaqë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës asnjë qeveri nuk arriti ta përmbyllë mandatit kushtetues, çka sjell si rezultat mbajtjen e vazhdueshme të zgjedhjeve të parakohshme.

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 27 GUSHT** - Pas shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka nisur përgatitjet, duke marrë disa vendime në funksion të përgatitjes së këtyre zgjedhjeve që do të mbahen më 6 tetor të këtij viti. Në mbledhjen e së martës, KQZ-ja ka marrë vendim për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, duke iu përshtatur ditëve që janë në dispozicion të KQZ-së për të organizuar këto zgjedhje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që fushata zgjedhore e partive politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të jetë dhjetë ditë, e cila do të fillojë më 25 shtator dhe do të përfundojë më 4 tetor. Afati për

regjistrimin e votuesve jashtë vendit do të jetë i hapur nga 30 gushti deri më 10 shtator, kurse afati për deklarimin e koalicioneve do të jetë deri në orën 00:00 të datës 30 gusht. Për organizimin e këtyre zgjedhjeve, KQZ-së i duhen rreth 6 milionë euro.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e së martës ka miratuar planin e buxhetit për zgjedhjet. Buxheti i planifikuar për këto zgjedhje është në shumën prej 5 milion e 698 mijë e 486 eurosh. Kërkesa buxhetore i është përcjell Qeverisë së Republikës të Kosovës.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se janë në pritje të buxhetit. "Presim që ky buxhet i kërkuar të alokohet për ne. Nëse s'kemi para, i zhvillojmë procedurat vetëm deri aty ku na mundësojnë procedurat ligjrisht", ka thënë ai.

Edhe anëtarët e partive politike





Flet për "Epokën e re", Muzafer Shala

# Qendrat inovative do të kenë

## - Me platformën inovative të rinjve do t'u ofrohen 50 mijë vende të punës

Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka thënë se me platformën e kësaj ministrie brenda një periudhe dhjetëvjeçare do të krijohen 50 mijë vende punë në IT. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qendrat inovative do të kenë shtrirje në tërë Kosovën. "Kemi paraparë që t'i kemi 15 qendra të inovacionit brenda katër vjetësh, po ashtu kemi paraparë t'i kemi 5 000 start up biznese inovative për një periudhë dhjetëvjeçare, kurse 1 800 sosh vetëm për katër vjetët e ardhshëm", ka thënë Shala. Në këtë intervistë Shala ka folur edhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, duke theksuar se PDK-ja në këto zgjedhje do të dalë partie e parë



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Shala, na tregoni një biografi të shkurtër tuajën dhe si erdhi deri tek emërimi juaj ministër Inovacionit, edhe pse emërimi juaj ndodhi pak ditë para se kryeministri të japë dorëheqje? Shala: Në moshën 22-vjeçare kam filluar punën në Shkollën e Mesme në Vushtrri, më pastaj kam shkuar në Angli, kam punuar mësimdhënës i matematikës dhe kam vazhduar studimet e mëtejshme. Tash e tetë vjet jam kthyer me bindjen që të punoj për vendim tim dhe kam filluar punën në institucione arsimore dhe në sektorin privat. Kam punuar në fabrikën e Llamkosit në Vushtrri. Pra, kam një përvojë të kombinuar. Edhe pse asnjëherë nuk kam qenë pjesë e strukturave të larta të PDK-së, kam qenë qytetar aktiv që kam punuar në Vushtrri dhe kam marrë pjesë në hartimin e planeve të PDK-së. PDK-ja dhe kryetari Kadri Veseli dolën me propozimin për emrin tim në krye të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Natyrisht, ishte moment emocional pasi është përgjegjësi dhe shërbim shtesë ndaj vendit pozita e ministrit.

"Epoka e re": Nëse PDK-ja do të jetë sërish në pushtet, nga prizmi juaj si do t'i zhvillojë inovacionin dhe ndërmarrësinë?

Shala: Partia Demokratike e Kosovës ndoshta është e vetmja parti që e ka një platformë e që është "Dekada e Re". PDK-ja ka ofertë të qartë për qytetarët pasi nuk është duke thënë ne kemi vija të kuqe, por e ka vetëm ofertën për qytetarët e që është "Dekada e Re". Jemi duke punuar me një grup të ekspertëve dhe më është kërkuar që të fokusohem në atë se cilët janë mekanizmat që kemi për t'i arritur në kuadër të objektivave të ministrisë, e jo vetëm të flasim. Ne, gjenerata e re e PDK-së, jemi më shumë teknokratë, jo vetëm politikanë. Ne kemi paraparë që brenda një kohe t'i krijojmë 50 mijë vende punë për IT.

"Epoka e re": Në çfarë periudhe kohore do të krijohen këto 50 000 vende pune në fushën e IT-së?

Shala: Llogaritjet që brenda shtatë apo dhjetë vjetësh, pasi nuk mund të flasim vetëm për kohën sa ne mendojmë për të qeverisur për katër vjet, por duhet të mendojmë më strategjikisht se ku do të jetë Kosova pas 20 vjetësh. Ne kemi

28 mijë e 500 nxënës të Gjinnazit Natyror (Shkollave të Mesme) dhe duhet të kemi strategji të qartë për ta, pasi janë potencial i madh për Kosovën dhe duhet t'i përgatisim këto kuadro, mirëpo kur t'i përgatisim atëherë kemi rrezik që do ta lëshojnë vendin, prandaj do t'u krijojmë mundësi të qëndrojnë në Kosovë.

"Epoka e re": Kur e përmendni shifrën prej 50 mijë vende pune, a mendoni se mund të sistemohen të gjithë në Kosovë apo po përgatisim kuadro edhe për eksport?

Shala: Po nëse i forcojmë këto kuadro dhe nuk hapim vende pune në Kosovë, atëherë këta shumë lehtë do të kenë për vende pune, sidomos në Gjermani që kemi target dhe ka nevojë për kuadro të teknologjisë. Ne jemi duke punuar që brenda pesë vjetësh të sjellim në Kosovë kompani të brendeve të njohura për fushën e IT-së.

"Epoka e re": A keni pasur takime apo kontakte me ndonjë përfaqësues të ndonjë brendi të njohur?

Shala: Javën e ardhshme do të jemi në Gjermani dhe qëllimi ynë është të krijojmë kontakte dhe përmes tyre po tentojmë për të trokitur në derë me qëllim që të kemi degë të tyre në Kosovë. Ne do t'i shfrytëzojmë edhe kanalet diplomatike, por qëllimi është të sjellim degë të tyre në Kosovë, të cilat më pas do të sjellin edhe vende të punës, e që do të shkonte në paralele, pra jo vetëm trajnime, por edhe vende të punës, pasi vetëm trajnimi i tyre do të ndikojë që të ketë eksport të të rinjve jashtë vendit, kurse të gërshtuara do të kemi edhe eksport të dijes. Pra, të rinjtë do t'i kemi këtu me paga të mira dhe do ta vazhdojnë punën në Kosovë.

"Epoka e re": Nga prizmi juaj, a kemi klimë të biznesit për të sjellë kompani të mëdha?

Shala: Po ju mund të pyesni se a

mund të punojnë kompanitë në Kosovë. Natyrisht se po, në bazë të informatave që i kemi marrë nga ATK-ja, kemi kompani që ka 600 punëtorë në fushën e telemarketingut dhe po funksionojnë, pra askush nuk është duke i penguar. Kemi kompani që i ka 170 punëtorë dhe ofrojnë shërbime për kompani në ShBA, por ankesë kryesore këto kompani kanë mungesën e kuadrove. Andaj jemi të interesuara për t'i zhvilluar kuadrot, duke qëndruar afër tyre. Nëse sot një kompani i ka 30 punëtorë, vitin e kaluar i kishte tetë punëtorë. Pse mos t'i ketë vitin e ardhshëm 100 punëtorë dhe pas disa vjetësh ky numër do të rritet edhe më shumë. Këta ndërmarrës po i quajmë "heronjtë e kësaj gjenerate" për faktin se po bëjnë zhvillimin ekonomik të vendit. Këta ndërmarrës do t'i forcojmë duke i mbështetur në aspektin financiar, por edhe t'ua hapim rrugën e bashkëpunimit me firmat internacionale. Një nga pronarët e një kompanie të



# shtrirje në tërë Kosovën



suksesshme në Kosovë ka shkuar në moshën dyvjeçare në Zvicër dhe pastaj është kthyer në Kosovë dhe sot në fushën e telekomunikimeve dhe zhvil-

limit të softuerëve i ka 200 punëtorë. Ky është një model që duhet marrë parasysh. Po ashtu, kemi raste kur individë të caktuar kanë punuar në kom-

pani të mëdha botërore dhe sot kanë hapur degët e atyre kompanive në Kosovë. Kam studentë të mi që punojnë në kompani të mëdha në botë, siç është

## PDK-ja do të dalë partia e parë

"Epoka e Re": Cilat janë pritjet tuaja për këto zgjedhje?

**Shala:** Pa dyshim se PDK-ja do të dalë partia e parë, sepse ka platformë dhe program të qartë për rininë. Këtë e shoh nga puna në terren që jemi duke bërë në vazhdimësi, por edhe nga kontaktet që kemi me strukturat në të gjithë Kosovën. Ardhja ime si ministër tregon se PDK-ja ka për qëllim që t'u japë hapësirë gjeneratave të reja. Pra, jemi dëshmitarë se ministrat e PDK-së, përjashtuar Bedri Hamzën, i përkasin gjeneratës së re.

"Vodafone", "Deloitte", "Cisco" të cilët i ka ftuar që të vijnë në Kosovë. Shumë shpejt do ta kemi platformën "Heronjtë e gjeneratës". Do të bëjmë thirrje publike që ata të vijnë në Kosovë dhe t'i hapin degët e kompanive të tyre. Nëse ata kanë problem që komunikojnë me CEO, pronarët e kompanive ku punojnë, atëherë ne do të komunikojmë me ta dhe do t'ua tregojmë modelin tonë.

"Epoka e Re: A pritjet që edhe në komuna të tjera të ketë qendra inovative?"

**Shala:** Për ta arritur numrin prej 50 mijë personash të punësuar në sektorin e IT-së duhet kthim i mjeteve për investime në këtë sektor. Kemi pastaj energjinë alternative, biomasës e shumë sektorë të tjerë që mund të jenë inovativë në Kosovë dhe të bëhen konkurrues edhe në tregun evropian, por që kthimi i mjeteve në këta sektorë është më i ngadaltë. Për t'i bërë të gjitha këto qendrat e inovacionit do të jenë një prej mekanizmave, pastaj do të jetë dhe qendra duale dhe platforma EDEX që është model i Harvardit. Qendrat inovative do të kenë shtrirje në tërë Kosovën.

Kemi paraparë t'i kemi 15 qendra të inovacionit brenda katër vjetësh, po ashtu kemi paraparë t'i kemi 5 000 start up biznese inovative për një periudhë dhjetëvjeçare, kurse 1 800 sosh vetëm për katër vjetët e ardhshëm.

Qendrat e inovacionit do të përdoren si parainkubator dhe inkubator, pra do të jenë edhe si qendra të trajnimeve. Do të kemi takim edhe me rektorin dhe Këshillin Drejtues të UP-së në mënyrë që të mundësojmë një model të qendrave të inovacionit siç është në Ohio, që kemi marrë elemente të kësaj qendre dhe ia kemi përshtatur Kosovës. Po ashtu, kemi synim stimulimin e patentave dhe publikimeve shkencore në revista me impakt faktor, pasi në Kosovë kemi hulumtime shkencore në baza individuale, por ne duhet të krijojmë grupe hulumtuesish. Duhet të krijojmë një institut shtetëror të hulumtimeve, i cili do t'u takojë të gjitha universiteteve. Nga përvoja ime shumë universitete dëshirojnë të hyjnë në konsurcium 20/20, ndërkaq universitetet e huaja neve nuk na pranojnë për shkak që nuk ka publikime me impakt faktor.

## Hapja e ambasadës japoneze do të thellojë marrëdhëniet bilaterale Kosovë-Japoni

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER)- Zëvendëskryeministri i parë në detyrë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të martën në takim ambasadorin japonez në Vjenë, jorezident për Kosovë, Kiyoshi Koinuma, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet e shkëlqyeshme që të dyja vendet gëzojnë, dhe për nevojën për thellimin e bashkëpunimit ekonomik mes të dyja vendeve. Në këtë takim është diskutuar edhe vizita shtetërore që presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi do ta zhvillojë në Japoni muajin e ardhshëm, dhe për pritshmëritë për rezultatet

konkrete të kësaj vizite. Hapja e ambasadës japoneze në Prishtinë në fillim të vitit të ardhshëm ishte temë diskutimi, për të cilën zëvendëskryeministri Pacolli është shprehur i bindur që do të ndikojë pozitivisht në thellimin e marrëdhënieve mes të dyja vendeve, dhe në të njëjtën kohë ofroi mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës në të gjitha etapat. Zëvendëskryeministri Pacolli e ka njoftuar ambasadorin Koinuma edhe me ecurinë e themelimit të Parkut të Biznesit Japonez, i cili do t'i ofrojë bizneseve japoneze kushte të favorshme për investime në Kosovë.

Në kuadrin e thellimit të bashkëpunimit ekonomik, ambasadori Koinuma e ka njoftuar zëvendëskryeministrin Pacolli për iniciativën e kryeministrit japonez, Shinzo Abe, për mbështetjen e zhvillimit ekonomik të Ballkanit Perëndimor, dhe në këtë kuadër Ambasada japoneze në Vjenë do të organizojë forumin ekonomik për promovimin e investimeve në Kosovë në fillim të muajit tetor. Po ashtu, në këtë takim është diskutuar edhe tema e dialogut me Serbinë, për të cilën Japonia është e interesuar që të mbarojë sa më parë, dhe njëherit përkrahë fuqishëm anë-



tarësimin e Republikës së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar. Në fund, zëvendëskryeministri

Pacolli e ka falënderuar ambasadorin japonez për pritjen e mirë që Japonia i ka bërë ekipit kosovar të xhudos.



## Djali i Adem Demaçit i bashkohet PDK-së

Shqiptar Demaçi, djali i simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçit, i është bashkuar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Lideri i PDK-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Kadri Veseli, ka thënë se ndihet krenar për bashkimin e Shqiptar Demaçit si profesionist në PDK. Ai ka bërë me dije se Shqiptari Demaçi është i përkushtuar që energjinë ta drejtojë në shëndetësi dhe ambient. Me këtë rast Veseli ka thënë se Adem Demaçi ishte frymëzuesi më i madh brez pas brezi për idealin e lirisë dhe rrugën e çlirimit



EPOKA E RE  
Faton DERMAKU

PRISHTINË, 27 GUSHT - Doktor Shqiptar Demaçi, djali i simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçit, i është bashkuar të martën Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), në mbështetje të Kadri Veselit për kryeministër të ardhshëm të vendit. Lideri i PDK-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Kadri Veseli, ka thënë se ndihet krenar për bashkimin e Shqiptar Demaçit si profesionist në PDK.

Me këtë rast ai ka thënë se Adem Demaçi ishte frymëzuesi më i madh brez pas brezi për idealin e lirisë dhe rrugën e çlirimit. "Adem Demaçi nuk u mposht asnjëherë. Ishte frymëzuesi më i madh për ne, brez pas brezi, në idealin e lirisë dhe rrugën e çlirimit. Bashkimin e shqiptarëve e kishte ideal jetësor, sa që edhe djali ia kishte lënë emrin Shqiptar. Shqiptar Demaçi, djali

i simbolit të rezistencës sonë kombëtare, një prej kirurgëve më të shquar, prej sot është pjesë e Partisë Demokratike të Kosovës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se Shqiptar Demaçi është i përkushtuar që energjinë e vet ta drejtojë në shëndetësi dhe ambient. "Ne jemi krenarë që jetuam në epokën e Adem Demaçit. Ne jemi krenarë që Shqiptar Demaçi, profesionist dhe personalitet shumë i respektuar, u bashkua me ne. Shqiptari është i përkushtuar që energjinë ta drejtojë në shëndetësi dhe ambient", ka deklaruar Veseli.

Po të martën Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) i është bashkuar edhe juristi dhe asamblisti i Kuvendit Komunal në Rahovec, Munib Durguti. Kryetari i PDK-së në Rahovec, Idriz Vehapi, i ka uruar mirëseardhje Durgutit. "Munib Durguti është një figurë e vlef-

shme për PDK-në dhe Komunën e Rahovecit, pasi vetëm me njerëz të ndershëm dhe punëtorë mund t'i kontribuojmë të mirës së përgjithshme", është thënë në njoftimin e PDK-së në Rahovec.

Një ditë më parë në PDK ka aderuar edhe Nol Krasniqi i cili

është asistent profesor në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. "Ai studimet master i ka përfunduar në Hungari, kurse studimet e doktoraturës tani po i vazhdon në Francë. PDK-ja u ka dhënë gjithmonë hapësirë dhe

mundësi të rinjve, të cilët me entuziazmin dhe energjinë e tyre kanë bërë vazhdimisht punë të shkëlqyeshme. Në këtë mandat qeverisës, me të rinj premtues ne do ta bëjmë edhe luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

## 'Katalogu i problemeve të Mitrovicës së Jugut', të gjitha vendbanimet kanë probleme infrastrukturore

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka zhvilluar katalogun e çështjeve për 11 komuna të Kosovës, që përfshinë problemet me të cilat përballen qytetarët dhe bën prioritizimin e disa çështjeve esenciale që duhet të përfshihen në planifikimet buxhetore të komunave për vitin 2020, të cilat po bëhen përgjatë gushtit përmes dëgjimeve buxhetore.

Fillimisht KDI-ja prezantoi katalogun e çështjeve për Komunën e Mitrovicës së Jugut, me informacione të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e hulumtimit të terrenit, si dhe duke u bazuar në intervistimin e banorëve të fshatrave dhe lagjeve të vizituara. Në këtë komunë janë identifikuar probleme në infrastrukturën rrugore, rrjetin e kanalizimit,



furnizimin me ujë të pijes, transport publik, gjendjen e

shkollave, menaxhimin e mbe-

turinave, në ndriçimin publik dhe shërbimet shëndetësore. Sipas hulumtimit, del se

pothuajse në të gjitha vendbanimet ka nevojë për intervenim në infrastrukturën rrugore. Në këtë komunë ka vendbanime që janë të kyçura pjesërisht apo nuk janë të kyçura fare në rrjet të kanalizimit. Si më emergjente konsiderohet ndërhyrja në përmirësimin e rrjetit të kanalizimit në fshatrat Këiq i Madh, Zasellë, Stantërg, Vërnice, Zhabar i Poshtëm dhe Mazhiq.

Po ashtu, janë 11 fshatra të cilët mungesën e ujit të pijshëm e shohin si pengesë për zhvillim. Në vendbanimet ku është realizuar ky hulumtim janë vetëm pesë fshatra që shfrytëzojnë transportin publik urban. Në ditën në vazhdim, KDI-ja do ta publikojë katalogun e dhjetë komunave të tjera të hulumtuara.



Edhe të martën ka vazhduar debati në mes të zyrtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për arritjen e koalicionit parazgjedhor

# Zvogëlohen gjasat për arritjen e koalicionit LDK - LV

Pavarësisht prej përpjekjeve, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) nuk po mund ta arrijnë koalicionin parazgjedhor. Madje kandidatura e Vjosa Osmanit për kryeministre nga radhët e LDK-së ka zvogëluar gjasat për realizimin e këtij koalicioni. Ndonëse nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se janë duke vazhduar negociatat për arritjen e këtij koalicioni, anëtari i Kryesisë së LV-së, Xhelal Sveçla, ka bërë me dije se kandidatura e Osmanit i ka shuar gjasat për arritjen e këtij koalicioni

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kandidatura e Vjosa Osmanit për kryeministre nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka zvogëluar gjasat për realizimin e koalicionit parazgjedhor me Lëvizjen Vetëvendosje (LV).

Anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Xhelal Sveçla, ka thënë të martën se veprimet e fundit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë treguar se nuk dëshirojnë koalicion parazgjedhor me Vetëvendosjen. Ai e ka quajtur tinëzuar vendimin e LDK-së për ta kandiduar Vjosa Osmanin për kryeministre. "Vetëvendosja bëri maksimumin, duke mos paragjykuar as emrin e kandidatit për kryeministër, në mënyrë që gjithçka të vendosej së bashku nga LV-ja e LDK-ja, por me vendimin e pakoordinuar dhe tinëzuar për të nxjerrë kandidat për kryeministër, LDK-ja tregoi se nuk dëshiron koalicion parazgjedhor", ka shkruar Sveçla në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas Sveçlës, LDK-ja po tregohet e pasinqertë përballë kërkesave transparente dhe publike të Lëvizjes Vetëvendosje për bashkëpunim. "Kjo sjellje e LDK-së vazhdon qysh prej një viti, me hezitim e mossinqeritet përballë kërkesave transparente e publike të LV-së për bashkëpunim. Dhe është pikërisht kjo tinëzari e LDK-së që e ka zvogëluar këtë subjekt 10% më pak në sondazhe brenda një viti, ndërkohë që ka rritur LV-në me të njëjtën marginë. Tash mbetet të shpresojmë që të paktën e mbajnë fjalën për të shkruar në zgjedhje



vetëm", ka deklaruar ai.

Sveçla ka thënë se Vetëvendosja është duke prirë dhe, sipas tij, Albini është politikani më i mbështetur. "Populli ka marrë vendimin për ndryshim, Vetëvendosje prin, Albini është politikani më i votuar dhe më i mbështetur", është shprehur Sveçla.

Por nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka thënë se liderët e dy partive janë duke punuar që të krijohet një koalicion parazgjedhor me Lëvizjen Vetëvendosje. Sipas tij, LDK-ja tashmë e ka vendosur që, me apo pa LV-në, posti i kryeministrit nuk do të negociohet. Haziri u ka bërë thirrje zyrtarëve të partive që të përmbahen me deklaratat e tyre dhe t'ua lënë

këtë punë liderëve të partive që ta negociojnë. "Është një format që ne kemi filluar që ta bisedojmë në nivelin e liderëve. Unë dhe Osmani e mbështesim arritjen e një marrëveshjeje politike. E kemi vullnetin dhe dëshirën. Unë do të apeloja që të jemi të përmbajtur nga deklaratime të tilla. Është proces të cilin liderët po e dërgojnë drejt zgjidhjes më të mirë për qytetarët", ka deklaruar Haziri.

Ai u ka bërë thirrje edhe pjesëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje që ta pranojnë Vjosa Osmanin kandidat për kryeministre, duke thënë se nuk duhet të dyshohet në kapacitetet e saj politike dhe profesionale. "LDK-ja ka besim të plotë, kapaciteti politik dhe profesional i Vjosa Osmanit është përtej çdo hezitimi që mund ta

ketë dikush nga kampi i Vetëvendosjes", ka theksuar Haziri.

Duke qenë të vendosur që pozita e kryeministrit t'i takojë LDK-së, kandidatja për kryeministre, Vjosa Osmani, ka thënë se thënë se fokusi për një bashkëqeverisje është me Lëvizjen Vetëvendosje dhe se në ditët në vijim do t'i vazhdojnë diskutimet bashkërisht. "Vetëvendosje duhet t'i bashkohet LDK-së për ndërtimin e një epoke të re të ndryshimeve të mëdha, të cilat do të jenë historike dhe që do ta çkapin shtetin nga krimi dhe korrupsioni", ka thënë Osmani.

Lidhur me deklaratimet e ish-deputetit të Vetëvendosjes, Xhelal Sveçlës, i cili e ka quajtur tinëzuar LDK-në, Vjosa Osmani, ka thënë se deklaratat e tilla tregojnë se kjo

lëvizje nuk ka pasur bashkëpunim të sinqertë dhe shprekon se ato mendime të mos të jenë edhe të lidhshme të kësaj partie.

Për koalicionet parazgjedhore të martën ka folur edhe njohësi i proceseve politike, profesori Rrahman Paçarizi. Ai ka thënë se, sipas rrethanave aktuale, nuk do të ketë koalicion parazgjedhor në mes të LDK-së dhe LV-së. "Po duket që s'ka koalicion LDK e LVV. PDK-ja deri tash s'po duket që ka partnerë. AAK e PSD, nëse nuk zgjerojnë koalicionin, do të ketë garë interesante. Nisma Socialdemokrate e AKR-ja s'ka dert nëse kooptojnë ndonjë parti të vogël me kandidatë të mirë. Një fushatë të tillë e kam dëshiruar", ka shkruar Paçarizi në llogarinë e vet në "Facebook".



## Labinot Tahiri aderon në AAK

PRISHTINË, 27 GUSHT - Ish-deputeti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Labinot Tahiri, të martën i është bashkuar Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Aderimi i tij është mirëpritur nga kryetari Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se konceptit 100% shtet po i bashkohen personalitete të shquara të jetës politike, akademike dhe kulturore e sportive. Haradinaj ka thënë se me deputetin Tahiri ka pasur një

bashkëpunim të shkëlqyeshëm për identifikimin dhe zgjidhjen e shumë sfidave të interesit kombëtar dhe, sipas tij, ky angazhim i përbashkët do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Aleanca shkon në zgjedhje me konceptin e saj 100% shtet, të cilit po i bashkohen personalitete të shquara të jetës politike, akademike dhe kulturore e sportive. Ndër ta, sot, me AAK-në u bashkua edhe deputeti i Kuvendit dhe humanisti Labinot Tahiri. I dashur për

publikun mbarëshqiptar, ai më ka qëndruar gjithnjë afër edhe gjatë sfidave në Hagë. Me deputetin Tahiri kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm për identifikimin dhe zgjidhjen e shumë sfidave të interesit kombëtar dhe ky angazhim i përbashkët do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Po ashtu, u pajtuam për mbajtjen e një pritjeje anëtarësimi, të enjten nga ora 19:00, në Sheshin '21", ka deklaruar Haradinaj.



# Prokuroria Speciale fillon hetimet rreth kontratës për ndërtimin e autoudhës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Lëvizja FOL ka mirëpritur hetimet e filluara nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për kontratën e ndërtimit të autoudhës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë. FOL-i që nga viti i kaluar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike ka kërkuar të gjithë dosjen e kësaj kontrate mirëpo, "përveç një pjese të dokumentacionit që na ishte ofruar, pjesa

tjetër, siç na kanë informuar zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës, nuk ekzistonte". FOL në vazhdimësi kishte ngritur shqetësimin për parregullsitë me të cilat ishte lidhur kjo kontratë dhe, për më tepër, si ishte e mundur të ndërtohet një auto-udhë pa pasur planin e menaxhimit të kontratës. "FOL është informuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes një

vendimi të datës 1 gusht 2019, mbi fillimin e hetimeve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për kontratën e ndërtimit të auto-udhës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë, apo e njohur në gjuhën teknike si: 'Kontrata për ndërtimin e autoudhës A7.1 - Kryqëzimi në disnivel A6/A7.1 (Banullë) - Dheu i Bardhë"', është thënë në komunikatën e FOL-it. Sipas FOL-it,

vendimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, përmes të cilit njoftohemi se ky institucion i ndërprente hetimet pas fillimit të hetimeve nga Prokuroria Speciale, rrjedh si rezultat i paraqitjes së ankesës nga ana e Lëvizjes FOL për mosofrim të disa dokumenteve të kontratës nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës, gjegjësisht mosofrimin e Planit të Menaxhimit të Kontratës, të cilën

tashmë dihet se nuk e ka kjo ministri. "Lëvizja FOL beson se Prokuroria Speciale do t'i dërgojë hetimet deri në fund për t'i vërtetuar shkeljet eventuale të cilat mund të jenë shkaktuar nga Ministria e Infrastrukturës në kuadër të procedurave për ndërtimin e auto-udhës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë", është theksuar në komunikatën e FOL-it.



## Firma gjermane, e gatshme për investime në Malishevë

MALISHEVË, 27 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me bashkëpunëtorë ka pritur në takim pune një delegacion të firmës gjermane "Scafom - Rux", i kryesuar nga menaxheri Marco Hiby dhe Emmanuel Salmon, ku koordinator i këtij takimi ka qenë Njazi Bytyçi, një afarist i suksesshëm me punë në Gjermani. Në këtë takim, Begaj ka njoftuar investitorët gjermanë me kushtet të cilat ua ofron Komuna e Malishevës këtyre investitorëve në resorin e ndërtimitarisë. Ai u ka treguar atyre se kjo

komunë tani ka zonën ekonomike e cila ofron shumë për të gjithë ata investitorë që janë të gatshëm që me bizneset e tyre të investojnë. "Ne si komunë bëjmë lehtësira për ofrimin e kushteve si në hapësirë dhe në infrastrukturë që kërkohet për zhvillimin e një biznesi, po ashtu edhe për sigurinë", është shprehur Begaj. Ndërsa investitorët gjermanë kanë mirëpritur gatishmërinë e institucioneve komunale për bashkëpunim dhe ofrimin e kushteve të cilat janë të nevojshme për fillimin e një biznesi.





# Borxhi i përgjithshëm i Kosovës tejkalon 1.1 miliard euro



AFP

**Borxhi publik i Kosovës ka kaluar vlerën prej 1.1 miliard eurosh. Pjesa më e madhe e borxhit është ndaj Bankës Ndërkombëtare për Ndërtim dhe Zhvillim (BNRZh) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ekspertë të çështjeve ekonomike theksojnë se vlera e borxhit aktual vazhdon të jetë e ulët krahasuar me përqindjen e bruto produktit vendor, por me tendencë të shpejtë të rritjes**

**PRISHTINË, 27 GUSHT** - Borxhi publik i Kosovës ka kaluar vlerën prej 1.1 miliard eurosh. Nga kjo vlerë më shumë se 721 milionë euro llogaritet borxhi i brendshëm, kurse 409 milionë euro është borxhi ndërkombëtar. Pjesa më e madhe e borxhit është ndaj Bankës Ndërkombëtare për Ndërtim dhe Zhvillim (BNRZh) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ndër vite, borxhi publik në Kosovë ka shënuar rritje. Në vitin 2014 vlera e borxhit të përgjithshëm ka qenë 582 milionë euro, kurse tri vjet më pas, në vitin 2017, kjo vlerë kishte arritur në 996 milionë euro. Vitin e kaluar borxhi tejkaloi 1 miliard

euro, kurse në gjashtë muajt e parë të këtij viti vlera e borxhit të përgjithshëm arriti në shumën prej 1 miliard e 131 milionë eurosh. Ekspertë të çështjeve ekonomike theksojnë se vlera e borxhit aktual vazhdon të jetë e ulët krahasuar me përqindjen e bruto produktit vendor, por me tendencë të shpejtë të rritjes. Muhamet Sadiku, profesor në Universitetin e Prishtinës, thotë se autoritetet kompetente kohën e fundit po hyjnë në borxhe pa menaxhuar në mënyrë efikase projektet. "Kosova në vitet e fundit ka filluar një aventurë më të madhe me ngufatjen e borxheve

të jashtme dhe kjo, siç duket, nuk është e shoqëruar me menaxhimin efikas të borxheve, për identifikimin e projekteve që kanë normën e rikthimit më të lartë në mënyrë që Kosova ta përballojë servisimin e kthimit të borxheve dhe jo të bie në situatë kur për këtë duhet të preken të hyrat buxhetore të shtetit", tha Sadiku.

Ndërkaq Naim Gashi, po ashtu ekspert i çështjeve ekonomike, thotë se Kosova ka nevojë për borxhe të huaja, por dyshon në përdorimin e duhur të këtyre mjeteve. Sipas tij, borxhi duhet ta stimulojë rritjen ekonomike dhe jo të përdoret pa u kalkuluar si duhet. "Unë mendoj se Kosova ka nevojë për marrjen e borxheve të jashtme, por në projekte që gjenerojnë zhvillim afatgjatë ekonomik, siç mund të jenë projektet në fushën e energjisë, të cilat ulin varfërinë në Kosovë nga importi dhe rrisin eksportin. Mandej projekte në aktivizimin e minierave metalurgjisë, në fushën e teknologjisë së informacionit, ku Kosova ka kapacitete të mëdha", tha Gashi. Banka Botërore në Kosovë para disa muajve ka paralajmëruar Qeverinë se borxhi publik në

Kosovë deri në vitin 2025 mund ta arrijë vlerën deri 30 për qind të bruto produktit vendor nëse rritja e shpenzimeve rrjedhëse vazhdon ta tejkalojë rritjen e të hyrave. Borxhi i përgjithshëm përkufizohet si "tërësia e borxhit shtetëror dhe borxhit komunal që merren në emër të institucioneve qendrore qeveritare të cilin Republika e Kosovës është e obliguar ta paguajë".

Borxhi i brendshëm është borxhi shtetëror i cili u nënshtruhet ligjeve të Republikës së Kosovës, ndërsa borxhi ndërkombëtar, është borxhi shtetëror i cili u nënshtruhet marrëveshjes me qeveritë e huaja, agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare financiare apo organizata dhe kompani të tjera të huaja në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare. Naim Gashi thotë se para vendosjes për marrjen e borxhit duhen përzgjedhur investimet kapitale, duke kalkuluar përfitimet që i sjellin komunitetit. "Asnjë shtet në botë nuk është zhvilluar pa marrë borxhe të jashtme, mirëpo, asnjë shtet në botë nuk është zhvilluar duke marrë borxhe të jashtme në mënyrë paushall. Nëse borxhi i jashtëm merret për zhvillimin afatgjatë,

qoftë ekonomik apo shoqëror, atëherë efektet janë pozitive. Nëse borxhet merren paushall për projekte të dyshimta, atëherë do të jetë një barrë shtesë për gjeneratat e reja që duhet të paguajnë një kosto financiare të cilën e shkaktojnë qeveritë dhe udhëheqësit aktualisht", tha Gashi.

Kreditë të cilat janë kontraktuar nga Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2018 i përkasin sektorit të infrastrukturës rrugore prej 65 përqindësh, sektorit të infrastrukturës ujore 18 për qind dhe sektorit publik me 17 për qind. Projektet të cilat financohen përmes borxhit ndërkombëtar janë projekte të cilat fillimisht aprovohen nga Komiteti për Investime Nacionale dhe janë pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Buxhetit Vjetor.

Në Ligjin për borxhet publike në Kosovë thuhet se në asnjë rast shuma e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të bruto produktit vendor. Por, sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Financave, në prill të këtij viti bruto produkti vendor në Kosovë ka arritur në 7.1 milionë euro.

## Filloi asfaltimi i rrugës Muqivërrc - Kranidell - Selishtë

**PRISHTINË, 27 GUSHT (ER)** - Të martën filloi asfaltimi i rrugës Muqivërrc - Kranidell - Selishtë, komuna e Kamenicës.

Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, ka thënë se kjo ministri mbetet e përkushtuar të krijojë infrastruk-

ture moderne në të gjitha fshatrat e Kosovës, që parandalon migrimin e brendshëm dhe krijon kushte të mira për zhvillim

ekonomik. Rruga Muqivërrc - Kranidell - Selishtë, është e gjatë 12 kilometra, investim i MIT-së në vlerë prej 1.1 milion euro.





## Më 5 dhe 6 shtator promovohen produktet tradicionale në Drenas

DRENAS, 27 GUSHT (ER) - Organizata Joqeveritare "Bliri" në Drenas do të organizojë një panair më 5 dhe 6 shtator 2019 në Sheshin

"Fehmi Lladrovci" në këtë komunë. Ky panair ka për qëllim fuqizimin ekonomik të grave në biznese, artizanale tradicionale, përpunimin e

pemëve dhe perimeve, kultivimin e mjaltit si dhe përpunimin e drurit. "Ftohen të gjithë të interesuarit e Komunës së Drenasit dhe me

gjerë, të jenë pjesë e këtij panairi i cili do t'i promovojë produktet vendore. Ju mirëpresim!", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



## Promovohet projekti i bashkëpunimit ndërkufitar Gjilan - Kumanovë

GJILAN, 27 GUSHT (ER) - Është promovuar projekti i bashkëpunimit ndërkufitar Gjilan - Kumanovë për "Treg të qëndrueshëm për produkte të freskëta të fermerëve", projekt ky tashmë në finalizim i cili është mbështetur nga Bashkimi Evropian (BE). Nën kryetari i Gjilanit, Arbër Ismajli, ka thënë se me këtë projekt kanë ruajtur tregtarin dhe ekonominë familjare. "Përkundër disa vështirësive, takimet tona të vazhdueshme me tregtarët dhe serioziteti ynë ka bërë që t'i bindim që tregu po

bëhet për ta dhe qytetarët e Komunës së Gjilanit. Me këtë projekt ne kemi dëshmuar se e kemi ruajtur tregtarin dhe ekonominë familjare. Ne ua kemi lehtësuar shumë punën në këto ditë të sezonit veror. Në emër të kryetarit Haziri e falënderojmë BE-në për mbështetjen në këtë dhe projektet e tjera. Urime tregtarëve dhe qytetarëve", ka thënë Ismajli. Ndërsa menaxheri i këtij projekti, Eroll Jonuzi, ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetjen e projektit në fjalë.



"Një falënderim i madh shkon për Komisionin Evropian që e mbështeti këtë projekt në vlerë prej 324 mijë eurosh, e që përkethehet me ndërtim të tregjeve në Gjilan, përkatësisht 100 shtande në tregun e gjelbër si dhe 30 shtande mobile në 'Arbëri', Përlepnicë e Dardani, ndërsa në Kumanovë, ndërtimi i pjesës së kulmit të tregut dhe tregut mobil me 20 shtande. Po ashtu, e falënderoj kryetarin Lutfi Haziri për mbështetjen e jashtëzakonshme që ky projekt ta shoh suksesin", ka thënë Jonuzi.

## QKMF-ja në Mitrovicë pajiset me rëntgen digjital

MITROVICË, 27 GUSHT (ER) - Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë (QKMF), është bërë të martën përrurimi i aparaturës më të re të rëntgenit digjital.

Në ceremoninë e përrurimit i pranishëm ishte kryetari i komunës, Agim Bahtiri, nënkryetari Faruk Mujka, drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj Barani dhe punëtorë të tjerë shëndetësorë.

Në fjalën e tij, kryetari Bahtiri ka thënë se është kënaqësi e veçantë që sot përrurojnë një mjet digjital i cili është shumë i rëndësishëm për qytetarët e Mitrovicës. "Sot, jemi mbledhur këtu për të përruruar këtë aparaturë shëndetësorë, vlera e të cilit arrin shumë mbi 100 mijë euro dhe është nga teknologjitë më të fundit. Ky investim i cili i dedikohet qytetarëve tregon se komuna është e përkushtuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes blerjes së aparaturave të reja", ka thënë kryetari Bahtiri.

Ndërsa drejtoresha e Shëndetësisë në komunën e Mitrovicës, Erseka Hasanaj Barani, tha se ndihet jashtëzakonisht mirë që Qendra Kryesore



e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë u pajis me një aparaturë moderne dhe cilësore, ku tani e tutje të gjithë qytetarëve të Mitrovicës do të ju ofrohen

shërbime shëndetësore kualitative. Ajo më tutje ka shtuar se ky projekt madhorë i cili kap vlerën mbi 100 mijë euro është vazhdimësi e furnizimit me

aparatura mjekësore, dhe është realizuar përmes investimeve kapitale komunale. Edhe drejtori i QKMF-së, Fevzi Sylejmani, e ka vlerësuar si

shumë të rëndësishëm pajisjen e QKMF-së me rëntgen digjital duke theksuar se tani e tutje do të ofrohen shërbime më të mira dhe më cilësore për qytetarët.

## Elezaj premtonte mbështetje për fshatrat Grabanicë, Dollovë dhe Bokshiq

KLINË, 27 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga drejtorë të drejtorive komunale, është takuar me banorë e fshatrave Grabanicë, Dollovë dhe Bokshiq, me të cilët ka diskutuar rreth projekteve që janë në realizim dhe për projektet që janë planifikuar nga komuna

për vitin e ardhshëm. Elezaj ka përmendur projektin për asfaltimin e rrugëve në fshatin Grabanicë, i cili ka filluar së realizuari dhe projektin e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në fshatin Bokshiq, për të cilin ka përfunduar faza tenderuese dhe pritet të fillojnë punimet. Ndërsa qyte-

tarët kanë shprehur kërkesat e tyre për projektet me prioritet për ta, me qëllim të përfshirjes së tyre në buxhetin komunal për vitet e ardhshme. Në anën tjetër, kryetari Elezaj është shprehur i gatshëm për përfshirjen e këtyre kërkesave në planifikimin për buxhet për vitet e ardhshme.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Fazliu: Na preku humbja, rikthehem ndaj Prishtinës

Astrit Fazliu e ka pranuar se humbja nga Ballkani e ka prekur mjaft skuadrën kampione të Kosovës, por beson se Feronikeli do t'u rikthehet fitoreve në derbin ndaj Prishtinës. "Në fundjavë na pret një ndeshje e vështirë ndaj Prishtinës dhe normalisht se përgjigjja më e mirë për humbjen në ndeshjen e fundit është fitorja në këtë derbi. Tri pikët nuk do të jenë të lehta për faktin se Prishtina ka skuadër të mirë, por angazhimi nuk do të mungojë për fitore", ka deklaruar Fazliu

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Feronikeli, në fundjavën që shkoi pësoi disfatë nga Ballkani (3-1). Sulmuesi Astrit Fazliu të martën në një bisedë për "Epokën e re" e pranoi se kjo humbje i ka prekur kampionët nga Drenas. "Atmosfera në klub është e mirë, por normalisht se humbja nga Ballkani na ka prekur. Jemi profesionistë dhe duhet ta kalojmë sa më shpejt edhe këtë", ka thënë Fazliu. Pas humbjes në Suharekë, skuadrën e "Niklit" e pret edhe një tjetër ndeshje e vështirë, por kësaj radhe do të luajë si vendës në "Rexhep Rexhepi" ndaj Prishtinës. Fazliu e ka lavdëruar skuadrën kundërshtarë,

por pret që skuadra të reagojë në këtë përballje dhe t'u rikthehet fitoreve. "Në fundjavë na pret një ndeshje e vështirë ndaj Prishtinës dhe normalisht se përgjigjja më e mirë për humbjen në ndeshjen e fundit është fitorja në këtë derbi. Tri pikët nuk do të jenë të lehta për faktin se Prishtina ka skuadër të mirë, por angazhimi nuk do të mungojë për fitore", ka deklaruar ai.

Pas dy ndeshjeve të zhvilluara, skuadra e Feronikelit është e katërta në tabelë me një fitore dhe një humbje, kurse ka shënuar pesë gola dhe ka pranuar katër. Ish-sulmuesi i shumë skuadrave në Kosovë, Astrit Fazliu, mungoi në ndeshjen e fundit, por është optimist se në ndeshjen e radhës do të jetë i gatshëm për t'i ndihmuar Feronikelit që të arrijë

fitore. "Kam munguar në ndeshjen e fundit për shkak të një lëndimi, por tash jam duke u përgatitur me skuadrën dhe besoj se do të jam i gatshëm për ndeshjen ndaj Prishtinës. Dëshira ime është që jam krah bashkëlojtarëve në këtë ndeshje shumë të rëndësishme", ka shtuar Fazliu.

Si fitues i Kupës dhe i titullit të kampionit, Feronikeli është paraqitur në garat e Ligës së Kampionëve e më pas edhe në Ligën e Evropës, por pa mundur të arrijë rezultate që ende nuk i kanë arritur skuadrat e tjera të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Kjo skuadër para fillimit të këtij edicioni bëri edhe ndryshime në shtabin teknik, duke e zëvendësuar trajnerin Zekrija Ramadani me trajnerin nga Mali i Zi, Dejan Vukiqeviq.

## SHKURT

## Legjenda e Fenerbahçes: Muriqi mund të shitet 50 milionë euro

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi, aktualisht është futbollisti më i përfolur në Turqi. Formën e Muriqit e ka komentuar edhe legjenda e Fenerbahçes, Ridvan Dilmen, duke thënë se sulmuesi nga Kosova mund të shitet për 50 milionë euro. "Fenerbahçe ka transferuar futbollistin më të mirë në 15 vjetët e fundit. Mos u befasoni nëse nesër klubi do ta shesë 50 milionë euro", ka deklaruar Dilmen.

## Shala mungon 6 javë

Trajneri i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, nuk mund të llogarisë në shërbimet e mesfushorit Herolind Shala, i cili është i lënduar. Skuadra e Shalës, Valerenga, ka konfirmuar se ai do të jetë jashtë fushës për gjashtë javë dhe kjo do të thotë se mesfushori do t'i humbasë ndeshjet e muajit shtator ndaj Çekisë dhe Anglisë.

## Nebih i prezantohet te Flamurtari

Skuadra e Flamurtarit ka zyrtarizuar edhe një tjetër futbollist. Bëhet fjalë për mesfushorin Kreshnik Nebih. Mesfushori 22-vjeçar, përveç një përvoje tek ekipi gjerman CFR Pforzheim në sezonin 2016-2017, pjesën tjetër të karrierës e ka kaluar në Kosovë, ku ka qenë pjesë e Hajvalisë, Gjilanit, Drenicës e, së fundmi, Vushtrrisë dhe Trepçës.

## Dushku përfaqëson FBK-në në kongresin e FIBA Botës

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, do ta përfaqësojë FBK-në në Kongresin e 21-të të FIBA Botës, që do të mbahet në Pekin të Kinës më 29 dhe 30 gusht. Dushku, gjithashtu, do të marrë pjesë në ceremoninë solemne të hapjes zyrtare të FIBA Kampionatit Botëror që do të mbahet në Kinë, si dhe do të jetë mysafire në dy ndeshje të Botërorit, Ishujt Faroe-Kina dhe Polonia-Venezuela. "Dushku në Kongresin e FIBA Botës do të jetë delegate me të drejtë vote në zgjedhjet që do të organizohen për presidentin dhe Bordin e FIBA Botës. Federata e Basketbollit të Kosovës është bërë anëtare me të drejta të plota në FIBA në vitin 2015, ndërsa kjo është hera e parë që FBK përfaqësohet në një Kongres të FIBA-s në nivel botëror", thuhet në njoftimin e FBK-së.

## Nora dhe Akili mbesin pa medalje në Japoni

PRISHTINË, 27 GUSHT - Ndryshe nga Distria Krasniqi dhe Majlinda Kelmendi, Nora dhe Akil Gjakova kanë mbetur pa medalje në Kampionatin Botëror të Xhudos që po mbahet në Tokio të Japonisë.

Nora Gjakova ka shënuar dy fitore ndaj Ling Chen Lien të Taipei dhe Justine Bishop të Zelandës së Re, kurse pësoi humbje në çerekfinale nga bullgarja Ivelina Ilieva me shënim të artë, kategoria -57

kg. Nora pësoi humbje edhe në repesazh nga francezja Sarah Cysique, kategoria -57 kg. Ndërsa Akil Gjakova shënoi një fitore ndaj Igor Wandtken të Gjermanisë, por në luftën

e dytë u mposhtë nga Behruzi Khojazoda i Takhikistanit. Garuesja e fundit e Kosovës në botëror është Lorian Kuka, e cila garon të premtën në kategorinë -78 kg.





## Muslija merr ftesë nga Challandesesi

HANNOVER, 27 GUSHT - Mesfushori i Hannoverit, Florent Muslija, në qershor vendosi zyrtarisht ta përfaqësojë Kosovën. Dokumentacioni i tij tashmë është kompletuar dhe ai është në dis-

pozicion të trajnerit Bernard Challandes. Mësohet se Muslija ka marrë ftesë zyrtare dhe do të grumbullohet për herë të parë me Kosovën më 2 shtator. Për shkak të mungesave të

shumta që kanë "Dardanët", trajneri Bernard Challandes pritet ta inkuadrojë në lojë që në ndeshjen e parë kundër Çekisë që zhvillohet më 7 shtator.



## Krasniqi dhe Harteli luftojnë për fitore

PRISHTINË, 27 GUSHT - Boksieri Haxhi Krasniqi do ta zhvillojë rimeçin ndaj Stefan Hartelit në muajin nëntor. Boksieri nga Juniku është shprehur i lumtur që Harteli i ka dhënë këtë mundësi, pasi është i bindur se nuk e ka merituar ta humbiste në përballjen e parë. "Hartel ka boksuar mirë në meçin e parë, por nuk më ka mposhtur. Në raundet e fundit ai shkoi pothuajse i nokautuar. Nëse nuk

do ta kisha qarjen në sy, do ta fitoja pa problem meçin. Nuk jam absolutisht dakord me vendimin e gjyqtarëve dhe për këtë mezi e pres rimeçin", ka thënë Krasniqi.

Për rimeçin ndaj boksierit nga Kosova ka folur edhe Stefan Hartel. Boksieri gjerman është i bindur që sërish do të dalë triumfues ndaj Krasniqit. "Do ta mposht përsëri Robinin. Është e nevojshme t'i bëj më në fund

gjërat e qarta në këtë drejtim. Pas spekulimeve të herës së fundit, tash më duhet dhe do t'i bëj gjërat edhe më të qarta. Kam vendosur ta ndjek këtë rrugë për ta vazhduar rrugëtimin për ta sfiduar titullin e kampionit të botës. Pas karrierës së gjatë si amator, tash jam në boksion profesionist dhe afër më të mirëve të botës. Dëshiroj ta shfrytëzoj këtë mundësi për një titull botëror", ka thënë Harteli.



## Bergeri: Vetteli mund të tërhiqet në fund të sezonit

BERLIN, 27 GUSHT - Sebastian Vetteli mund të tërhiqet nga garat e Formulës 1 në fund të këtij sezoni edhe pse piloti gjerman ka një kontratë deri në vitin 2020 me Ferrarin. I këtij mendimi është Gerhard Berger, ish-pilot i "kokëkuqes". "Unë besoj se kjo gjë mund të ndodhë. Sebastian është inteligjent. Ai ka shumë gjëra të tjera më interesante në jetë për të bërë. Për Vettelin familja ka shumë rëndësi, ka fëmijë, ka fituar mjaftueshëm para, ndaj nuk ka nevojë për të tjera. Për më tepër, ai është i lidhur ngushtë me motorët dhe makinat e vjetra që ka", ka thënë Bergeri. Muajt e fundit janë shtuar spekulimet për një tërheqje të katër herë kampionit të botës, që është në sezonin e pestë me Ferrarin. Me shumë gjasa edhe këtë vit Vetteli



nuk do të fitojë dot një titull kampion. "Nuk ka për të qenë e lehtë të marrë këtë vendim, por koha po kalon. Ai nuk po bën mjaftueshëm përparim me ekipin e tij", ka shtuar Bergeri. Ish-piloti austriak bën një krahasim mes Vettelit dhe Michael Schumacherit: "Është ndryshe

nga Michaeli, që ishte më i ashpër me skuadrën dhe kishte komandën. Këtë gjë Sebastiani nuk e ka, pasi nuk është në natyrën e tij, që pëlqen më shumë t'i përpunojë gjërat. Ai mendon se drejtuesit janë përgjegjës për funksionimin e skuadrës".

### SHKURT

#### Vogel: Xhaka ishte më mbresëlënës se Shaqiri

Ish-trajneri i Baselit, Heiko Vogel, beson se Granit Xhaka ishte futbollisti më i mirë që ai e kishte parë në Basel, duke i kaluar Xherdan Shaqirin dhe Mohamed Salahun. Xhaka ishte një nga shumë futbollistë që depërtuan nga skuadra e njohur zvicerane te klubet e mëdha evropiane. "Granit Xhaka ishte lojtar më mbresëlënës gjatë kohës sime në Basel. Ju duhet ta dini kontekstin. Xherdan Shaqiri erdhi me pritshmëri të larta dhe ai menjëherë u integrua në skuadër dhe bëri punë të mrekullueshme", ka thënë Vogel për "Goal". "Në vitin e parë në kampionat, ne ishim jashtëzakonisht afër triumfit. Në xhiron finale ne e kishim një ndeshje si mysafir kundër Young Boysit, që ishte për titull", u shpreh Vogel.

#### Barça bën ofertën finale për Neymarin

Neymari është një nga emrat më të diskutuar kohët e fundit, pasi ka vendosur të largohet nga PSG-ja dhe e ardhmja e tij nuk dihet ende se ku do të jetë. Një delegacion nga Barcelona është nisur drejt Parisit, për të bërë një ofertë përfundimtare për Neymarin. Oferta mendohet të jetë rreth 170 milionë euro dhe në marrëveshje mund të futet edhe kartoni i Osman Dembele, për të cilin parisienët kanë shfaqur interesim kohët e fundit.

#### Eriksen nuk largohet nga Tottenhami

Mesfushori i Tottenham Hotspurit, Christian Eriksen, do të mbetet në klubin anglez pavarësisht se e pranoi hapur dëshirën për t'u larguar nga "Spurs"-i. "Daily Mail" raporton se shpresat e danezitet për t'u larguar janë shuar, pasi asnjëra prej skuadrave të interesuara për të nuk kanë arritur marrëveshje me klubin e Tottenhamit.

#### Dudeki: Gerrardi e zëvendëson Kloppin në Liverpool

Jerzy Dudek beson se Steven Gerrardi është kandidati i vetëm serioz për ta zëvendësuar Jurgen Kloppin kur të largohet nga Liverpooli. "Kur isha në Liverpool kohët e fundit askush nuk e mbajti sekretin e faktit që Steven është kandidati kryesor dhe i vetëm për ta zëvendësuar gjermanin kur të vijë epoka e tij në 'Anfield'", ka thënë Dudek në një intervistë për "Przegląd Sportowy". "Të gjithë e dinë që herët a vonë, kapiteni i madh do të kthehet. Jam befasuar që Steven filloi të punojë si menaxher kaq shpejt. Shumica e shokëve të mi të ekipit ose lojtarëve nga e gjithë bota kanë nevojë për kohë para se të kthehen përfundimisht në futboll", ka shtuar Dudek.

#### Dybala-Icardi, afër shkëmbimit

Juventusit thuhet se është i gatshëm ta lejojë largimin e Paulo Dybalas në këto ditë të fundit të afatit kalimtar. Nga ana tjetër edhe Interi po e dëshiron largimin e Mauro Icardit, sidomos pas deklaratave të Wanda Naras, se ai nuk e ka dashur asnjëherë largimin nga "Giuseppe Meazza". "La Gazzetta dello Sport" raporton se "Zonja e Vjetër" dhe "Nerazzurët" janë në bisedime për shkëmbimin e La Joyas me sulmuesin problematik. Dybala në fillim të kësaj vere kishte refuzuar kalimin te Interi, mirëpo në fitoren ndaj parmës në fundjavën e kaluar, qëndroi në stol. Maurizio Sarri i ka bërë me dije argjentinasit se nuk është në planet e tij dhe se e dëshiron një zgjidhje sa më të mirë për të. Icardi në njëfarë forme kishte pranuar se nga Interi do të largohej vetëm për transferimin në "Allianz Stadium", e që shkëmbimi në mes të dy klubeve duket më i mundshëm se kurrë më parë.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

## REKRUTIM

**Institucioni:** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

**Agjencia për Regjistrim të Bizneseve**

**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar i lartë për Teknologji Informative  
**Koeficienti/8**  
**Nr. i Referencës:** MTI/26  
**Numri i zyrtarëve që do të pranohen:** 1  
**Vendi:** Prishtinë  
**Data:** 28/08/2019

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Administron sistemin e ARBK-së;
- Mirëmban rrjetin e brendshëm të ARBK-së;
- Kontrollon aspektet e sigurisë së sistemit TI dhe identifikon nevojat e tanishme dhe të ardhshme për TI, duke bashkëpunuar me strukturat e të gjitha niveleve;
- Menaxhon me ActiveDirectory (usersandcomputers) në bashkëpunim me ASHI- në;
- Menaxhon me File Server të ARBK-së;
- Planifikon, menaxhon dhe mirëmban aplikacionet tjera që operojnë kryesisht në familjen Windows server si dhe kryen dokumentacionet përkatëse;
- Rregullisht kontribuon në zhvillimin e koncepteve të reja, teknikave dhe standardeve;
- Përgjigjet në të gjitha kërkesat e stafit të ARBK-së që kanë të bëjnë me fushën e IT-së, si dhe kryen edhe detyra tjera që kërkojnë nga mbikëqyrësi.

**Kualifikimet për këtë vend të punës:**

- Diplomë universitare: Shkenca Kompjuterike;
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Certifikata për trajnime profesionale në lëmin e IT-së;
- Njohuri për programe kompjuterike dhe njohuri për server;
- Njohja e gjuhës angleze (përparësi);
- Aftësi për rrjedhat e punës dhe procedurat;
- Aftësi për punë nën presion dhe fleksibilitet në punë.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Kohëzgjatja e emërimit:**

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese. Dymbëdhjetë (12) muaj.

**Data e mbylljes së konkursit:**

**11/09/2019**

**Paraqitja e kërkesave**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org) dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: **11/09/2019**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

*"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".*

*"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"*

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj službi Republike Kosovo, Zakon br. 03/L-149, Uredba Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo Trgovine i Industrije objavljuje:

## REGRUTOVANJE

**Institucija:** Ministarstvo Trgovine i Industrije

**Agjencia za Registraciju Biznisa**

**Naziv radnog mesta:** Viši službenik za Informacionu Tehnologiju  
**Koeficient/8**  
**Referentni Br:** MTI/26  
**Broj zvaničnika koji će biti prihvaćeni:** 1  
**Mesto:** Priština  
**28/08/2019** Datum:

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Upravlja sistemom ARBK-a;
- Održava internu mrežu ARBK-a;
- Proverava bezbednosne aspekte IT sistema i identifikuje trenutne i buduće potrebe za IT, saradujući sa strukturama na svim nivoima;
- Upravlja Active Directory (users and computers) u saradnji sa AID;
- Upravlja File Server ARBK-a;
- Planira, upravlja i održava druge aplikacije koje operišu uglavnom na Windows server porodici i obavlja relevantnu dokumentaciju;
- Redovno doprinosi razvoju novih konceptata, tehnika i standarda;
- Odgovara na sve zahteve osoblja ARBK-a koji se odnose na IT oblast, kao i obavljanje drugih dužnosti koje zahteva nadzornik

**Kvalifikacije za ovo radno mesto:**

- Univerzitetska Diploma: Kompjuterske Nauke;
- Minimum 3 godine stručnog iskustva;
- Sertifikat o stručnom usavršavanju u oblasti IT;
- Poznavanje kompjuterskih programa i poznavanje servera;
- Poznavanje Engleskog Jezika (prednost);
- Sposobnost za radne procese i procedure;
- Sposobnost rada pod pritiskom i fleksibilnošću na poslu.

**Uslovi za učešće u regrutovanju:**

Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova, koji su potpuno sposobni da deluju, imaju visoko obrazovanje i imaju profesionalnu sposobnost za obavljanje dužnosti.

**Trajanje imenovanja:**

Službenik karijere (trajni). Probni period: dvanaest (12) meseci.

**Datum zatvaranja konkursa:**

**11/09/2019**

**Podnošenje zahteva**

Obrasci za apliciranje preuzimaju se na recepciji MTI-a, ili se preuzimaju sa web stranice MTI-a, gde je objavljen konkurs, na adresi [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org) podnose se Diviziji za Ljudske Resurse, svakog radnog dana od 8:00 -16:00 časova do: **11/09/2019**. Za detaljnije informacije možete kontaktirati na tel. 038-200 36-578.

*"Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu".*

*"Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno predstavljanje u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave kao što je definisano u Članu 11, stav 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo"*

Nepotpune aplikacije i podnesene posle krajnjeg roka neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati izabrani na užem spisku će biti kontaktirani.





Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



**Institucioni :** Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L. – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall konkurs për këtë pozitë:

### KONKURS

**Titulli i punës :** Zyrtar për Mbështetje Operative

**Nr.ref.** RN00005459

**Kategoria funksionale :** Niveli administrativë

**Koeficienti :** 6

**Lloji i pozitës :** I karrierës

**Orët e punës :** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** 1 vit periudha provuese

**Vendi i punës :** Prishtinë

**Mbikëqyrës:** Bordi / Drejtori i Departamentit për Administratë

**Qëllimi i vendit të punës:** Ofrimi i mbështetjes administrative dhe teknike për Bordin e ARII-ës

**Detyrat Kryesore**

- Ndihmon në organizimin e punës dhe menaxhimin efikas të aktiviteteve të përditshme të zyrës së Bordit
- Bashkëpunon me udhëheqësit e departamenteve, divizioneve dhe zyrave sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit.
- Përgatit raporte periodike të aktiviteteve të Bordit
- Ofron mbështetje administrative dhe teknike për Bordin Mbikëqyrës
- Pranon / Shpërndan dokumente që i drejtohen bordit
- Azhurnon kopjet elektronike dhe fizike të dokumenteve të ndryshme
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve të bordit
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës.

**Shkathësitë e kërkuara**

- Diplomë universitare, Fakulteti Juridik, Ekonomik, Administratë Publike ose SHIL - 2 vite përvojë pune;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e shërbimeve administrative;
- Shkathësi për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar me stafin e nivelit administrativ;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese të informacionit;
- Afësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Interneti);

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Adresa: Rr. Rrustem Statovci Nr 29 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në ueb faqen zyrtare [www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurroni.

“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



**Institucija:** Regulativni Autoritet Železnica

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo, br. 03/L. - 149 i Uredbe br. 02/2010 o proceduri zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosovo, Regulativni autoritet železnica objavljuje konkurs za ova radna mesta:

### KONKURS

**Naziv radnog mesta:** Službenik za podršku operativan

**Ref. br.** RN00005459

**Funkcionalna kategorija:** Administrativni nivo

**Koeficijent :** 6

**Vrsta pozicije:** Karijerna

**Radno vreme:** 40 časova nedeljno

**Trajanje imenovanja:** 1 godina probnog perioda

**Radno mesto:** Priština

**Nadzornik:** Odboru / Direktor Odeljenja za Administraciju

**Svrha radnog mesta:** Pružite administrativnu i tehničku podršku Odboru RAŽ

**Glavne dužnosti**

- Pomaže u organizaciji rada i efikasnom upravljanju svakodnevnim aktivnostima kancelarije Odbora
- Saraduje sa rukovodiocima odeljenja, odeljenja i ureda prema uputama supervizora.
- Pripremite periodične izvještaje o aktivnostima Odbora
- Pruža administrativnu i tehničku podršku Nadzornom odboru
- Prima / distribuira dokumente upućene odboru
- Ažurira se elektronskim i fizičkim kopijama različitih dokumenata
- Upravlja kalendarom sastanaka odbora i događajima
- Izvodi i druge poslove na zahtev.

**Potrebne veštine**

- Univerzitetska diploma, Pravni fakultet Ekonomski, Javna Uprava ili SV 2 godine radnog iskustva
- Znanje i iskustvo u oblasti usluga upravni
- Sposobnost organizovanja rada i koordinacije sa administrativnim osobljem
- Istraživačke veštine, analitički evaluator od informacije
- Sposobnost izvršavanja zadataka i zadataka pod pritiskom
- Računarske veštine primene programe (Word, Excel, Power Point, Internet);

**Preuzimanje i dostavljanje aplikacija:**

Aplikacije se preuzimaju i dostavljaju u Kancelarijama Regulativnog Autoriteta Železnica, Adresa: Ul. Rrustem Statovci Br. 29 Priština, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Aplikacija se može preuzeti i na službenoj veb stranici [www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja konkursa.

Aplikaciji treba priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koja se zahteva za ovo radno mesto za koje konkurišete.

“Civilna služba Kosova služba pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje svih građana Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.”

“Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe javne uprave na centralnom i lokalnom nivou kao što je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosovo”.

“Aplikacije dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune aplikacije će biti odbijene”. Aplikaciji treba priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i ostalu potrebnu dokumentaciju koja se zahteva za ovo radno mesto za koje konkurišete. Samo kandidati odabrani na užem spisku biće kontaktirani.

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E ZVEÇANIT

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe nenit 3 dhe 4. Rregullores për procedurën e rekrutimit në shërbimin civil Nr.02/2010, si dhe nenit 8. paragrafi 1 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, nenit 3. paragrafi 1. të Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik (Nr.07/2017), Komuna e Zveçanit me datën 26.08.2019. shpall:

### KONKURS PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE

<b>1. Emri i vendit të punës:</b>	Zyrtar për emergjencë
<b>Kodi:</b>	SHP/050
<b>Grada:</b>	9
<b>Koeficienti:</b>	6
<b>Lloji i pozitës:</b>	Karijere
<b>Numri i ekzekutuesve:</b>	1
<b>Orët e punës:</b>	40 orë në javë

#### Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara

- Diplomë universitare (të shkencave teknike, fakulteti për siguri ose të ngjashme) dhe të paktën dy (2) vjet përvojë pune profesionale.

#### Departamenti për Shëndetësi

<b>2. Emri i vendit të punës:</b>	Motra Medicinale/tenik
<b>Kushtet:</b>	Shkolla e mesme e medicines e përfunduar
<b>Orët e punës:</b>	40 orë në javë
<b>Numri i ekzekutuesve:</b>	2

- Perioda e nënshkrimit të kontratës: Periudha provuese prej 6 (gjashtë) muajsh, me mundësi vazhdimi kontratës.

#### INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURËN E KONKURENCËS

#### Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikimi (mirret në zyrën nr.33 në ndërtesën e Komunës së Zveçanit)
- Një kopje të diplomës (e vërtetuar nga noteri)
- Një kopje të certifikatës së ekzaminimit të jurisprudencës - nëse kërkohet (vërtetuar nga noteri).
- Certifikata e përvojës së punës.
- Dy rekomandime (nëse ka).
- Një kopje të dy raporteve të fundit të vlerësimit të punës (nëse ka).
- Konfirmimi se ai nuk ishte nën hetim dhe nuk u dënua për një veprim penal.
- Kopja e kartës së identitetit.
- Çertifikatat.

Informata të detajuara për të gjitha pozicionet me përshkrimet e vendeve të punës, kualifikimet e kërkuara, përvojën e punës dhe aftësitë e tjera mund të merren në zyrën nr. 33 në ndërtesën e komunës së Zveçanit, si dhe në faqen e internetit të komunës [www.eopstinazvecan.com](http://www.eopstinazvecan.com).

#### Konkursi mbetet i hapur për 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit, duke filluar nga data 28.08.2019. deri më 11.09.2019.

Kërkesat e dërguara pas mbylljes së konkursit nuk do të merren në konsideratë. Kërkesat e paplotësuara mund të refuzohen. / Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen /

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen, ata do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të konfirmimit nga email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumente origjinale të kualifikimit dhe trajnimeve. Në rast të mosnjohjes së dokumentacionit origjinal, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/

"Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Aplikacionet mund të merren- shkarkohen dhe dorëzohen çdo ditë pune në Zyrën nr. 33 në ndërtesën e Komunës së Zveçanit - rruga Kralj Milutini p.n. prej orës 8:00 deri në orën 14:00.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E ZVEÇANIT

Na osnovu člana 11. i 12. Zakona o Civilnoj Službi br.03/L-149 i člana 3. i 4. Pravilnika o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi br. 02/2010, kao i člana 8. Stav 1. Zakona o radu br. 03/L-212, člana 3. Stav 1. Administrativnog uputstva za regulisanje procedura radnog odnosa u javnom sektoru (Br.07/2017), Opština Zvečan, dana 26.08.2019. godine objavljuje:

### KONKURS ZA PRIJEM U RADNI ODNOS

<b>1. Naziv radnog mesta:</b>	Službenik za emergjencije
<b>Kod:</b>	SHP/050
<b>Grejd:</b>	9
<b>Koeficijent:</b>	6
<b>Vrsta pozicije:</b>	Karijere
<b>Broj pozicija:</b>	1
<b>Radno vreme:</b>	40 časova nedeljno.

#### Kvalifikacije i zahtevane sposobnosti

- Univerzitetska diploma (tehničkih nauka, fakultet za bezbednost ili slično), najmanje 2 godine profesionalnog radnog iskustva

#### Odeljenje za zdravstvo

<b>2. Naziv radnog mesta:</b>	Medicinska sestra/tehničar
<b>Uslovi:</b>	Završena srednja medicinska škola
<b>Radno vreme:</b>	40 sati
<b>Broj izvršilaca:</b>	2

- Period zaključenja ugovora: Probni rad u trajanju od 6 (šest) meseci, uz mogućnost produženja ugovora

#### OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE U VEZI SA PROCEDUROM KONKURISANJA

#### Tražena dokumentacija:

- Aplikacija (preuzima se u kancelariji br.33 u zgradi opštine Zvečan)
- Kopija diplome (overena od stranc notara)
- Kopija uverenja o položenom pravosudnom ispitu-ukoliko se traži (overeno od stranc notara).
- Potvrda o radnom iskustvu.
- Dve preporuke (ako imate).
- Kopija dva poslednja izveštaja o vrednovanju rada (ako takve postoje).
- Potvrda da nije pod istragom i da nije osuđivan za krivično delo.
- Kopija lične karte.
- Sertifikati.

Detaljne informacije o svim pozicijama sa opisom posla, traženim kvalifikacijama, radnim iskustvom i ostalim veštinama, možete dobiti u kancelariji br. 33 u zgradi opštine Zvečan kao i veb stranici opštine [www.eopstinazvecan.com](http://www.eopstinazvecan.com)

#### Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počev od 28.08.2019.god. do 11.09.2019.god.

Zahtevi poslati nakon zatvaranja konkursa neće se uzeti u obzir. Nekompletirani zahtevi mogu biti odbijeni. / Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/

Zbog velikog broja dobijenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor, biće kontaktirani putem (e-maila) ili u nedostatku potvrđivanja email-om od strane kandidata, biće obavesteni putem telefona i dužni su da ponesu sa sobom originalna dokumenta o kvalifikacijama i izvršenim obukama. U slučaju nedostavljanja originalne dokumentacije, kandidati će biti isključeni iz regrutacione procedure.

Civilna služba Kosova pruža jednake uslove zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.

Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu predstavljeni proporcionalno na organima javne službe na lokalnom i centralom nivou, kao što je naznačeno u Čl.11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.

Aplikacije se mogu preuzeti i podneti svakog radnog dana u Kancelariji broj 33 u zgradi opštine Zvečan – ulica Kralja Milutina b.b. u periodu od 8:00 do 14:00 časova





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond*

Bazuar në nenin 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të neni 4 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të Statutit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Fondi i Sigurimit Shëndetësor shpallë këtë Konkurs Publik.

Data e publikimit: 28/08/2019

Nr. Referencës: Fssh-05/08/2019

### SHPALLJA E KONKURSI

**Institucioni:** Fondi i Sigurimit Shëndetësor

**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar për regjistrim të të dhënave

**Paga Bruto:** 400 €

**Nëpunësi mbikëqyrës:** Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Sis. të Informacionit

**Orari i punës:** 40 orë në javë

**Lloji i kontratës:** Për punë dhe detyra specifike

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Mbledhja, përpunimi dhe kontrollimi i të dhënave burimore.
- Regjistrimi i të dhënave burimore në data bazë të Sistemeve të brendshme të FSSH-së
- Rishikimi dhe korigjimi i mangësive ose gabimeve eventuale tek të dhënat aktuale të regjistruara në data bazë.
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon sipas nevojës me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;
- Kryen detyrat e parapara me planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse brenda afateve kohore të caktuara
- Detyra tjera të cilat mund të kërkohen nga Menaxheri;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurimit:** Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotëson kriteret e konkursit.

**Shkollimi i kërkuar:** Diplomë Universitare në Fakultetin Ekonomik, Juridik, Shkenca Komputerike.

#### Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen;

- Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë paraprake të dëshmuar në mbledhje dhe regjistrim të të dhënave në Sisteme të ndryshme.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme
- Krijimi i marrëdhënieve të mira ndërpersonale;
- Aftësi të mira analitike dhe propozime për vendosje të çështjeve;
- Njohja e gjuhës angleze, përparësi;

#### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacionin së bashku me CV
- Letër Motivuese
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës

Data e publikimit dhe e mbylljes së konkursit: 28/08/2019 deri më 11/09/2019

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Fondin e Sigurimit Shëndetësorë dhe dorëzohen në zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore, Zyra nr.13, adresa: Prishtinë, Lakërishtë, Rruga Tirana. Objekt "Beni Dona". Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Informacionet shtesë mund të mirën në këtë nr tel: 038 20080705

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Petrit Bruqi  
 Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond*

Na osnovu člana 8 i član 10 stav 2 podstav 2.3 Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i u skladu sa članom 4 i članom 5 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju procedura konkurisanja u javnom sektoru, kao i na osnovu Statuta Fonda za zdravstveno osiguranje, Fond za zdravstveno osiguranje objavljuje javni konkurs.

Datum objavljivanja: 28/08/2019

Br. reference: Fzo-05/08/2019

### OBJAVA KONKURSA

**Institucija:** Fond za zdravstveno osiguranje  
**Naziv radnog mesta:** Zvaničnik za informisanje i saradnju  
**Plata Bruto:** 400€  
**Nadzornik službenik:** Šef odeljenja za Upravljanje Sistemima Informacije  
**Radno vreme:** 40 časova u nedelji (puno radno vreme)  
**Vrsta ugovora:** O radu i specifičnim zadacima

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Prikupljanje, obrada i kontrola izvornih podataka.
- Evidentiranje izvornih podataka u bazi podataka Internih sistema FZO-a
- Pregled i ispravljanje nedostataka ili eventualnih grešaka u trenutnim podatcima zabeženim u bazi podataka.
- Koordinacija rada sa drugim jedinicama institucije i komunikacija prema potrebi sa spoljnim organima;
- Obavljanje bilo kojeg drugog zadatka u određenom profesionalnom polju u skladu sa važećim zakonima i propisima koji se sa povremeno mogu razumno zahtevati;
- Izvođenje predviđenih zadataka u planovima rada usvojenim u skladu sa odgovarajućim zakonima, propisima, politikama i procedurama unutar datim vremenskim okvirima
- Druge zadatke koje može zahtevati Menadžer;

**Uslovizaučešće u regrutovanju:** Pravo aplikacije imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu poslovnu sposobnost, koju su završili adekvatno obrazovanje i koji imaju profesionalnu sposobnost u obavljanju poslova

**Procedura konkurisanja:** konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate koji ispunjavaju kriterije.

**Potrebno obrazovanje:** Univerzitetska diploma Ekonomskog/ Pravnog fakulteta, Fakultet Komjuterskih Nauka

#### Potrebne veštine / iskustvo i drugi atributi;

- Prioritet će imati kandidati sa dokazanim iskustvom u prikupljanju i evidentiranju podataka u različitim sistemima;
- Poznavanje važećih zakona i propisa;
- Stvaranje dobrih međuljudskih odnosa;
- Dobre analitičke sposobnosti i predlaganja u rešavanju pitanja;
- Poznavanje engleskog jezika smatraće se prioritet;

#### Kandidati treba da predaju sledeća dokumenta:

- Prijavu zajedno sa CV-om
- Motivaciono pismo
- Dokaze o školovanju, radnom iskustvu
- Kopiju lične karte ili pasoša

**Datum publikacije i zatvaranja konkursa: 28/08/2019 do 11/09/2019**

**Podnošenje zahteva:** Prijave se preuzimaju u Diviziji za ljudske resurse u Fondu za zdravstveno osiguranje i predaju se u kancelariji Divizije za ljudske resurse, kancelarija br. 13, na adresi: Prishtina, Kupusište, Ul. Tirana, objekat „Beni Dona“. U prijavi treba da se jasno navede naziv radnog mesta i broj reference. Dodatne informacije se mogu dobiti na ovaj br. telefona: 038 20080705

Prijave poslate nakon datuma zatvaranja konkursa i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Petrit Bruqi  
 Rukovodilac divizije za ljudske resurse





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të nenit 4 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të Statutit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Fondi i Sigurimit Shëndetësor shpallë këtë Konkurs Publik.

Data e publikimit: 28/08/2019  
Nr. i Referencës: Fssh-04/08/2019

## KONKURS

**Institucioni:** Fondi i Sigurimit Shëndetësor  
**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar i lartë për Analizë, Planifikim dhe Menaxhim të Kontratave të Shërbimeve Shëndetësore (2 pozita)  
**Koeficienti:** 8  
**Nëpunësi mbikëqyrës:** Udhëheqësi i Divizionit për Analizë dhe Planifikim  
**Kohëzgjatja e Kontratës:** Me kohë të caktuar, me mundësi të vazhdimit  
**Orari i punës:** 40 orë në javë (orar të plotë)  
**Periodha provuese:** Gjashtë (6) Muaj

### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Analizon dhe vlerëson gjendjen shëndetësore, planifikon nevojat për shërbime shëndetësore me anë të mbledhjes së informative, zbaton kriteret e cilësisë së shërbimeve të përcaktuara nga MSh, të procesit të kontraktimit të shërbimeve shëndetësore nga SHSKUK dhe institucionet tjera shëndetësore në vend dhe jashtë vendit;
- Siguron ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor për qytetarët dhe banorët e Republikës së Kosovës në mënyrë, vëllimin dhe cilësinë e përcaktuar me Ligjin e Shëndetësisë, si dhe për qytetarët që nuk janë banorë të Republikës së Kosovës në mënyrë, vëllimin dhe cilësinë e përcaktuar me Ligjin e Shëndetësisë.
- Përgatit informacionin për qytetarët e Kosovës për Listën e shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor dhe çmimet e këtyre shërbimeve shëndetësore, në mënyrë transparente dhe të kuptueshme për qytetarët;
- Administron kontratat, që nënkupton procesin e përgatitjes, rishikimit, përshtatjes dhe analizës së aspektit profesional të kontratave për shërbime shëndetësore dhe /ose kontratave për performancë;
- Grumbullon dhe analizon raportet nga institucionet shëndetësore të kontraktuara në Kosovë dhe jashtë Kosovës, në sistemin publik apo privat, që janë përgjegjëse për dorëzimin e raporteve të rregullta të punës dhe performancës, sipas nenit 60 të Ligjit të Shëndetësisë; Njëkohësisht duke bërë edhe monitorimin dhe kontrollin e tyre në aspektin e performancës dhe cilësisë.
- Analizon raportet e performancës, sipas shkallës së përbushjes së indikatorëve, të përcaktuar nga FSSH;
- Raporton për të gjitha veprimet e ndërmara, rezultatet, problemet dhe çështjet e ngjashme me këto.
- Zbaton mekanizmat dhe përkrahë (rishikon, përcjellë) Cnimoren e shërbimeve shëndetësore si dhe Listën e kujdesit shëndetësor themelor
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurimit:** Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kriteret e konkursit.

**Shkollimi i kërkuar:** Diplomë universitare në mjekësi, Juridik, Ekonomik, Administrat publike.

### Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Se paku 3 (tri) vite përvojë pune profesionale të dëshmuar me dokumente;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme
- Krijimi i marrëdhënieve të mira ndër-personale;
- Aftësitë e mira analitike dhe propozime për vendosje të çështjeve;
- Njohja e gjuhës angleze e preferuar

### Kandidatet duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacionin së bashku me CV
- Letër motivuese
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës

Data e publikimit dhe e mbylljes së konkursit: 28/08/2019 deri me 11/09/2019

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, dhe dorëzohen në zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore, Zyra nr.13, adresa: Prishtinë, Lakërishtë, Rruga Tirana. Objekti "Beni Dona". Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Informacionet shtesë mund të mirren në këtë nr tel: 038 20080705  
Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Petrit Bruqi  
Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

